


Sistemi i Gjykatave në Shqipëri

Pushteti gjyqësor në Republikën e Shqipërisë ushtrohet nga:

- Gjykatat e Shkallës së Parë të cilave mund t'i drejtohen për mbrojtjen e të drejtave të shkelura.
- Gjykatat e Apelit të cilave mund t'i drejtohen për të ankuar vendimin e dhënë nga Gjykatat e Shkallës së Parë.
- Gjykata e Lartë që mund t'i drejtohen kur vendimet e Gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk janë marrë në përputhje me ligjin. Me ndryshimet e bëra, rëndësia e kësaj Gjykate rritet pasi të gjitha vendimet e saj luajnë rol unifikues.



Ky botim u mundësua nga
Koalicioni "Drejtësi për të gjithë"

AKSESI NË DREJTËSI I QYTETARËVE GARANCITË E REFORMËS NË DREJTËSI

Çfarë Synon Reforma në Drejtësi?

- Të rrisë perceptimin pozitiv dhe besimin e qytetarëve
- Të minimizojë korrupsionin e institucioneve të drejtësisë
- Të rrisë profesionalizmin dhe përgjegjshmërinë e sistemit
- Të konsolidojë barazinë e qytetarëve para ligjit
- Të çrrënjos kulturën e pandëshkueshmërisë

Çfarë është aksesimi në drejtësi?

- Aksesimi në Drejtësi është garancia kushtetuese që i mundëson individëve mbrojtjen e të drejtave të shkelura. Shtetet janë të detyruara të garantojnë të drejtën e cdo individi për t'ju drejtuar Gjykatës ose organeve të tjera të administratës publike.

- Aksesimi në Drejtësi, si element i rëndësishëm i shtetit të së drejtës, gjen rregullim në aktet kryesore (kushtetuta dhe ligjet) si edhe në aktet ndërkombëtare që janë të detyrueshme për t'u zbatuar. Çdo person që kërkon të mbrojtë të drejtat e tij të shkelura mund t'i drejtohet një gjykate të pavarur dhe të paanshme, e cila ka detyrim të zhvillojë një proces të rregullt ligjor dhe brenda një afati të arsyeshëm.

Aksesi dhe Kushtetuta

Çdo person mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për mbrojtjen e të Drejtave dhe lirive Themelore të tij:

- ➔ Pasi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive;
- ➔ Brenda një afati 4 muor nga konstatimi i shkeljes;
- ➔ Për çdo shkelje që vjen nga akte të pushtetit publik ose vendim gjyqësor, me kusht që shkelja të jetë reale dhe të prekë drejtpërdrejtë individin.

Aksesi dhe Kodi i Procedurës Civile

Ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Civile synojnë të rrisin garancinë për gjykime më efektive, reduktimin e zvarritjes së procesit gjyqësor dhe afatet që duhet të përmbushen gjatë gjykimit të një çështje:

- ➔ Të gjykohen brenda afatit 1 vjeçar të gjitha çështjet e ngritura përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës Administrative të Apelit.
- ➔ Të gjykohen brenda afatit 2 vjeçar çështjet civile të ngritura përpara Gjykatës së Shkallës së Parë, Apelit dhe Gjykatës së Lartë si dhe çështjet Penale të ngritura përpara Gjykatës së Shkallës së Parë.
- ➔ Nëse këto afate nuk respektohen, ndryshimet parashikojnë mundësinë e individit t'i drejtohet Gjykatës për të kërkuar:
 - përshpejtimin e procedurave të hetimit;
 - përshpejtimin e gjykimit;
 - përshpejtimin e ekzekutimit të vendimit;
 - shpërblimin e dëmit;
- ➔ Gjykimet e çështjeve me vlerë të vogël do të shqyrtohen me një procedure të veçantë dhe të shkurtuar.

Aksesi dhe Kodi i Procedurës Penale

A e dini se me ndryshimet e Kodit të Procedures Penale, viktimat gëzojnë një mbrojtje më të zgjeruar të të drejtave?

Viktima ka të drejtë të:

- ➔ Kërkojë ndjekjen penale të fajtorit duke iu drejtuar Prokurorit;
- ➔ Kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat;
- ➔ Informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimën e tij;
- ➔ Njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit;
- ➔ Bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedurën, për të pushuar akuzën ose çështjen;
- ➔ Kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal;
- ➔ Dëgjohet nga gjykata edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar;
- ➔ Përfshihet nga pagimi i çdo shpenzimi dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale;
- ➔ Zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas;
- ➔ Përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;
- ➔ Komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar;
- ➔ Viktimat e abuzuara seksualisht të gëzojnë të drejtën të kërkojnë të dëgjohen nëpërmjet mjeteve audiovizive, në mënyrë që mos të kenë kontakte të drejtpërdrejta me abuzuesin.

